

RAPORTI PARAPRAK

I

VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

TE AKTIVITETIT:

**“NDERTIM DHE SHFRYTEZIM PER PRODHIM DHE PERPUNIM
XHINSESH (KONFEKSIONESH)”**





Subjekti: ERMANDI sh.p.k

Vendndodhja: Ish Zona Industriale Lushnje, Qarku Fier

Pergatiti materialin : “Eko- Studio- Projekt” sh.p.k

Tirane, 2015

PERMBAJTJA

-  Hyrje
-  Baza ligjore
-  Metodika e vleresimit te mjedisit
-  Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

4. MASAT PER ELEMINIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE

6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrushem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

“Ndertim dhe shfrytezim per prodhim dhe perpunim xhinsesh (konfeksionesh)”

Raporti i *Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis* siguron qe ndikime mjedisore te rendesishme jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim dhe zbatim te projektit.

Kur parametrat mjedisore nuk jane konform ligjeve, normave dhe rregullave te mjedisit, rrjedhimisht kemi ndotje te tij dhe prishje te ekuilibrave natyror. Nxitja e zbatimit te ketyre normave kerkon nje perkujdesje nga ana e organeve legjislativ dhe vendimmarrese, ne menyre qe te rritet interesi si dhe detyrimi per ruajtjen e ekuilibrave natyror.

Ne kete raport *Vleresimi Ndikimi ne Mjedis* eshte trajtuar aktiviteti:

“Ndertim dhe shfrytezim per prodhim dhe perpunim xhinsesh (konfeksionesh) “

Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis eshte nje studim qe synon parashikimin e te gjitha efekteve te pritshme ne mjedis, qe do te rezultojne nga projekti i propozuar, si gjate zbatimit te tij dhe gjate funksionimit.

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedis te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjese marrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

➤ Profili i propozuesit

Subjekti "ERMANDI" sh.p.k është rregjistruar pranë QKR-se me datë 28/12/2004 , me numër NIPT-ti K53706401M . Vendi i ushtrimit të aktivitetit është në **Ish Zona Industriale Lushnje, Qarku Fier.**

1.1 Qellimi i projektit

Qellimi përcësor i projektit është ndërtimi i objektit për të zhvilluar me pas aktiviteti për prodhim dhe përpunim xhinsesh (konfeksionesh). Qellimi i këtij aktiviteti është tregtimi me shumicë dhe pakicë të produkteve të cilat do të prodhohen.

1.2 Numri i njerezve që do të punesohen dhe nga do të vijne

Zhvillimi i aktiviteti do të ketë ndikime pozitive përse i përket nivelit ekonomik të zonës sepse do të ketë punësim të popullsisë vendase pasi zhvillimi i aktivitetit për prodhim dhe përpunim xhinsesh (konfeksionesh) do të ketë nevojë për një numër të konsiderueshëm punonjësish. Këta punonjës do të jenë të përhershëm dhe do të punojnë pesë ditë të javës nga 8 orë në ditë, me një turn. Punonjësit do të pajisen me uniformë dhe do të instruktohen nga drejtuesi teknik për rregullat teknike gjatë proceseve të punës. Në mënyrë rigorozë do të zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë.

1.3- Kerkesat e përdorimit të tokës

Për zhvillimin e aktivitetit nuk do të kërkojë tokë shtesë sepse ndërtimi do të kryhet në katin e sipërm të një ndërtese të subjektit **ERMANDI sh.p.k** i cili në katin e poshtëm zhvillon një aktivitet tjetër. Sipërfaqja e projektuar i plotëson të gjitha kriteret për zhvillimin e aktivitetit , është e mjaftueshme, ka hapësirë të bollshme.

Përshkrimi i Subjektit

Kjo shoqeri është një investim I shoqerise **ERMANDI sh.p.k.** Qellimi i aktivitetit eshte prodhimi dhe perpunimi I konfeksioneve (xhinseve), import eksporti ne industrine e konfeksioneve, prerje , qepje, stampime, qendisje, perpunim konfeksionesh, larje, lyerje te konfeksioneve e tregtimin e tyre.

Perpunimi i pantallonave xhinse eshte nje operacion shërbimi plotësues per te rritur vleren e materialeve te perpunuar dhe per ti perputhur ato me shijet e tregut duke respektuar kerkesat e konsumatoreve ne krijimin e dizenjove te ndryshme dhe duke krijuar larmishmeri ne dizenjo.

Veprimtaria është pjesë përbërëse e zhvillimit të industrisë së prodhimit të veshjeve, në përputhje me kërkesat e tregut por dhe të parametrave cilësore të këtij malli.

Lenda e pare,e cila eshte cope xhinsi ne forme rulosh me metrazh te gjate dhe magazinohet ne magazinën perkatese. Kjo lende e pare hyn ne repartin e prerjes, ku behet prerja e xhinsit sipas modeleve te ndryshme. Pasi priten, qendisen dhe kalojne ne repartin e qepjes, ne rrobaqepesi. Ne repartin tjeter vendosen stampat. Pas kesaj xhinset kalojne ne repartin e gervishtjes, ku edhe u behet gervishtja.

Me pas kalohet ne repartin e paketimit ku vendosen aksesoret perkates, behet pastrimi nga fijet, qepja e etiketave te meshinit, hekurosja dhe kontrolli final per defekte. Ne fund behet palosja, vendosja e etiketave dhe ndarja ne kuti kartoni sipas kerkesave.

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

- **Gjeologjia e rajonit**

Ne kete rajon kemi te bejm me tokat e hirta e te kafta , keto toka jane formuar mbi shkembinj argjilor te neogjenit. Kane profile te diferencuara me ngjyre te hirte te kuqerremte, perberje mekanike subargjilore te mesme ne te rende. Perberja kimike e tyre tregon se jane mestarisht te pasura me humus. Persa i perket elementeve ushqyes te asimilueshme nga bimet keto toka paraqiten te varfere me azot dhe fosfor dhe te pasura ne patos. Kuota ku eshte ngritur ky aktivitet eshte me nje ngritje te vogel nga toke bujqesore e cila lejon qe te kemi vetrrjedhje te ujervae te bardha dhe te reshjeve. Nga ana gjeologjike ne bazamentin ne bazamentin ku eshte ndertuar ky aktivitet ka te bej me formacionin kuaternar Q₄AL. Formacioni argjilor nuk lejon qe ujerat siperfaqesore te reshjeve si dhe uejrat e ndotura te futen ne thellesi, por ato per shkak te kuotes se larte dhe kanaleve kullues drejtohen drejt kanalit kryesor ku para se te shkojne ne kuoten me te ulet ka nje grope dekantimi.

- **Klima**

Lushnja ashtu si e gjithë Shqipëria bën pjesë në brezin e klimës mesdhetare, dhe dallohet për tipare më të shprehura mesdhetare, e cila karakterizohet nga vera e nxehtë dhe e thatë me shkëlqim të madh të diellit dhe dimër i butë dhe me rreshje të mëdha. Ngricat dhe dëborat janë dukuri tepër të rralla. I nxehti fillon që prej mesit të pranverës dhe vazhdon deri në fund të tetorit. Klima e Lushnjes është e ngrohtë sepse laget nga deti dhe është i mbrojtur nga lindja prej erërave të ftohta. Lushnja dallohet për numrin e lartë të ditëve me diell, mesatarisht 2800 ore në vit. Rreshjet kanë rregjim kohor shumë të çrregullt ato janë përqendruar kryesisht në gjysmën e ftohtë të vitit, sasia mesatare e tyre arrin 980-1000 mm/vit. Vera në Lushnje është e thatë dhe shpesh nuk bie shi për javë të tëra. Muajt më të lagesht janë nëntori dhe janari, kurse muajt më të thatë korriku dhe gushti. Erërat fryjnë në drejtime të ndryshme por gjatë dimrit mbizotëron era e jugut, e cila sjell edhe rreshje të mëdha, ndërsa gjatë verës era fryn nga veriu dhe veriperëndimi. Afërsia me detin bën

qe klima te jetë e butë dhe vetëm ne raste tepër te rralla temperaturat të bien nën zero. Temperatura mesatare vjetore lekundet nga 150C-160C. Klima e Fierit lejon zhvillimin e një bujqësie shumë degëshe. Gjithashtu tokat bujqësore mund të shfrytëzohen 2-3 herë ne vit. Zona ku do zhvillohet aktiviteti ka klime mesdhetare fushore. Temperatura mesatare me e larte eshte ne muajin korrik, gusht 23 °C, dhe me e uleta ne muajin Janar 7.2 °C. Ndryshimi i lageshtise relative te ajrit gjate vitit eshte i lidhur ngushte me ecurine e temperatures se ajrit. Vlerat me te larta te lageshtise jane ne periudhen e ftohte te vitit ndersa me te uleta ne periudhen e ngrohte te tij. Per arsye se jemi prane zones fushore dhe ne afersi te detit mbizoterojne erera nga kuadrati i perendimit dhe veri perendimit. Ne dimer mbizoterojne erera te lindjes dhe te jugut.

- **Trashegimia arkitektonike**

Aktiviteti qe kryhet nuk prek zonat turistike, zona te mbrojtura, zona arkeologjike, arkitektonike, objekte te trasheguara dhe te ndertuara nga njeriu me rendesi historike, sepse ne kete zone ato nuk ekzistojne. Eshte per t'u theksuar se ne kete zone nuk ka monumente kulture, zona arkeologjike dhe gjeomonumente.

- **Flora dhe fauna**

Bota natyrore bimore dhe shtazore e rrethit është transformuar nga veprimtaria e njeriut. Megjithatë zona dallohet për disa lloje bimesh e kafshesh sidomos ne pjeset bregdetare e fushore. Takohen disa lloje kafshesh si urithi, cakalli, nusja e lales, dhelpra, shkurteza, mellenja, thelleza e fushes si dhe disa lloje te ndryshëm zvarranikesh e gjarprinjs. Ndërsa ne ujerat e detit gjenden shumë lloje peshqish si qefulli, levreku, koca etj. Zona bën pjese ne brezin e shkurreve dhe te pyjeve mesdhetare. Shkurret perbehen nga nenkati I makies, ku rriten shkurret me gjelberim te perhershëm si mareja, shqopa, gjineshtra, dafina. Ne këtë nenkat bimor rriten edhe disa drure te lartë si selvia, valanidhi, pisha e bute dhe e eger, qe ne disa raste formojne pyje te vegjel.

- **Pasurite ujore**

Ne kuadrin e pasurive natyrore rëndësi të veçantë kanë pasuritë ujore, ku përveç detit Adriatik, rrethi përshkohet nga lumenjtë Seman, Vjosë e Gjanica. Semani - 281 km i gjatë formohet nga bashkimi i Devollit me Osumin në afërsi të Beratit. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 5949 km², prurja mesatare vjetore e tij arrin në 96 m³/sek. Semani është ndër lumenjtë më eroziv, duke e bërë lumin me eroziv në vend. Vjosa - 272 km i gjatë buron nga malet e Pindit në Greqi. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 6700 km², ndërsa prurja mesatare vjetore e tij arrin 195 m³/sek. Gjanica - 67 km buron nga burimet e Poçemit e të Kalivaçit. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 234 km². Është një nga lumenjtë më të ndotur në vend, për shkak të derdhjes së naftës. Rrethi ka edhe disa liqene artificiale ku më i madhi e më i rëndësishmi prej tyre është ai i Kurjanit me sipërfaqe 375 ha, ujërat e tij përdoren për ujitje.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

Nje nga objektivat eshte edhe identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen gjate fazes se funksionimit te aktivitetit.

o Ndikimet ne popullsi

Realizimi i aktivitetit nuk do te kete ndikime ne levizjen apo zhvendosjen e popullsisë se rajonit ku do zbatohet aktiviteti. Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk ka emetime ne ajer, toke apo uje te cilat ndotin ambjentin dhe te rrezikojne shendetin e punonjesve apo te popullsisë se rajonit.

o Ndikimet e aktivitetit te zhvillimit ne rruget lokale dhe transportin

Subjekti ka krijuar rruge hyrese per ne objekt te cilen e miremban ne vazhdimësi. Gjatë zbatimit të aktivitetit nuk do kete ndryshime të rrjetit të rrugëve lokale dhe transportit. Për rrjedhojë aktiviteti nuk do ndikojë absolutisht në rrugët lokale dhe transport, përkundrazi subjekti është angazhuar të mirembajë rrugët lokale të transportit me qëllim të mbarvajtjes së mirë të aktivitetit të tij.

o Ndikimet ne toke

Aktiviteti nuk gjeneron mbetje te ngurta te rrezikshme qe te demtojne mjedisin, te vetmet mbetje qe krijohen jane ato qe vijne nga aktiviteti i perditeshem i personelit te cilat grumbullohen ne nje vend te caktuar dhe me pas largohen per ne vendin e caktuar nga komuna.

o Ndikimet ne ajer

Referuar natyres se procesit qe zhvillohet nuk kemi sasi gazesh te shkarkuar ne atmosfere. Edhe makinat e transportit do te kontrollohen vazhdimisht per kushtet teknike te tyre ne mnyre qe te mos kete clirim gazesh jashte normave nga djegia e karburantit.

○ *Ndikimet ne ujera*

Zhvillimi i aktivitetit nuk do te sjell ndotje te mjediseve ujore pritese. Ujerat e ndotura urbane jane sistemuar dhe derdhen ne rrjetin e kanalizimeve ku ben pjese projekti.

○ *Ndikimet ne klime*

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

○ *Ndikimet ne floren dhe faunen*

Zona në te cilen ushtrohet aktiviteti është një zonë në të cilën nuk takohen elemente te spikatur te flores. Perreth kësaj zone, mund te hasim bimesi te ulet dhe barishte te ndryshme. Aspekti faunistik i lidhur ngushte me mjedisin rrethues ketu paraqet nje larmi biologjike te varfer, qe eshte po keshtu nje pasqyrim i gjendjes se ketij ekosistemi tashme te degraduar.

○ *Ndikimet nga zhurmat*

Ndikimet nga zhurmat jane brenda normave te lejuara brenda territorit ku do te kryhet aktiviteti.

4. MASAT PER ELEMINIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE

Me qellim minimizimin e efekteve negative mjedisore dhe rritjes se efekteve pozitive ne mjedis, nga ana e shoqerise do te sigurohet marrja e masave si me poshte:

Territorri perreth fabrikes

I gjithe territori i fabrikes dhe sheshet e levizjes jane te shtruara dhe te sistemuara. Nga shoqeria jane marre masa edhe per gjelberimin e territorit perreth fabrikes duke bere te mundur mbjelljen me peme , gjithashtu nga stafi do tregohet kujdes per mbajtjen paster te ambientit dhe sperkatjen e tij here pas here me uje.

Emetimet ne ajer

Gjate procesit të prodhimit dhe perpunimit te xhinseve, shkarkimet e gazeve të dëmshëm në atmosferë jane minimale dhe brenda normave te lejuara. Do te mbahet ne vazhdimesi ne gadishmeri ,sistemi i filtrimit te ajrit ne ambjentet e brendshme,do te ndizen aspiratoret.

Mbetjet e ngurta

Aktiviteti nuk gjeneron mbetje te ngurta qe te demtojne mjedisin, te vetmet mbetje qe krijohen jane ato qe vijne nga aktiviteti i perditeshem i personelit te cilat grumbullohen ne nje vend te caktuar dhe me pas largohen per ne vendin e caktuar nga pushteti lokal. Mbetjet e ngurta qe do te dalin nga procesi teknologjik do te depozitohen ne vendin e percaktuar nga organet e Pushtetit Lokal.

Shkarkimet e ujerave

Gjate punes me kapacitet te plote do te mbahet ne kontroll te vazhdueshem sistemi filtrimit te ujit industrial si dhe te monitorohet uji qe perfundon procesin teknologjik perpara shkarkimit ne mjedis.

Zhurmat

Niveli i zhurmave në fabrike do të jete në parametra normal dhe në nivele të pranueshme sepse pajisjet dhe makinerite mirembahen në kushte të mira teknike duke mos kryer ndotje akustike.

Rastet aksidentale

Do merren masat për parandalimin e tyre, pajisjet në fabrike do kontrollohen vazhdimisht për gjendjen teknike të tyre. Shoqëria siguron se do ketë nderhyrje të menjehershme nëse do të ketë ndikime negative në mjedis.

Kushtet e punës

Përsa i përket sigurimit teknik të punonjësve ata do të jenë të mirë informuar mbi rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punës, konform rregulloreve përkatëse për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit. Gjithashtu shoqëria do të pajisë me uniforma dhe mjete mbrojtëse.

Vlerësimi i efektivitetit të pritsëm të masave zbutëse

Realizimi i objektivave dhe treguesve të pritsëm të parashikuar do të varet nga respektimi i të gjithë treguesve të përcaktuar. Kontrolli dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve të punës në shoqëri do të çojnë përfundimisht në një proces pune të kontrolluar me shkarkime brenda normave, duke mos sjellë pasoja për shëndetin e njerezve dhe mjedisin përreth.

❖ KONKLUZIONE

- ✓ Zbatimi i projektit do te kontribuojë ne rritjen ekonomike ne nivel lokal dhe kombetar si dhe rritjen e mundesive per vende te reja pune.
- ✓ Procesi teknologjik nuk do te shoqerohet me shkarkime të lëngta të rrezikshme. Gjate procesit te punes do kemi perdorim masiv te ujit vetem per te ftohur makinerite
- ✓ Niveli i zhurmave në fabrike eshte ne parametra normal dhe ne nivele të pranueshme sepse pajisjet qe punojne duke llogaritur siperfaqen e hapur nuk kryejne ndotje akustike.
- ✓ Per nje pune sa me optimale në fabrike zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe punonjesit njihen me keto rregulla ne menyre periodike.

❖ REKOMANDIME

- Te merren masa dhe te kryhet reabilitimi i mjedisit ne rastet e ndonje aksidenti.
- Te kryhet rregullisht kontrolli gjendjes teknike te pajisjeve dhe mjeteve te transportit.
- Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik.
- Te largohen te gjitha mbetjet ngurta qe krijohen si rezultat i aktivitetit njerezor ne vendet e percaktuara nga pushteti lokal.

Per “EKO - STUDIO - PROJEKT” sh.p.k

Ing. Xhevair DERMYSHI